

Vendim i KM nr. 247, datë 30.4.2014.

Fletore zyrtare Nr.65, Date 12.05.2014

“Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”

V E N D I M

P Ë R

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË KËRKESAVE E TË PROCEDURAVE PËR INFORMIMIN DHE PËRFSHIRJEN E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJEN MJEDISORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM).
2. Për qëllim të këtij vendimi, do të zbatohen përkufizimet përkatëse të ligjit nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

K R E U I

INFORMIMI I PUBLIKUT GJATË PROCEDURËS PARAPRAKE TË VNM-SË

1. Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin këto faza:
 - a) Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;
 - b) Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit.
2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit për procedurën paraprake të VNM-së, publikon në faqen e saj të internetit, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e plotë për projektin, siç është paraqitur nga zhvilluesi.
3. Në publikimin e saj, AKM-ja sqaron:
 - a) procedurën që do zbatohet dhe afatin e parashikuar të marrjes së vendimit e të publikimit të tij në faqen e saj të internetit;
 - b) mënyrën dhe afatin kohor (20 ditë) të dhënies së mendimeve të publikut përpara marrjes së vendimit;
 - c) mënyrën dhe afatin e ankimit ndaj vendimit.
4. Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, vendimi i AKM-së publikohet i plotë në faqen e saj të internetit, ku publiku dhe palët e tjera të interesuara sigurojnë një kopje të plotë të tij.

KREU II
INFORMIMI, KONSULTIMI DHE DËGJESA PUBLIKE
GJATË PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-SË

1. Informimi dhe përfshirja e publikut gjatë procedurës së thelluar të VNM-së përfshin këto faza:

- a) Informimin e publikut për projektin e propozuar dhe marrjen e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;
- b) Informimin e publikut për komunikimin që AKM-ja bën me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;
- c) Informimin, ndërgjegjësimin dhe konsultimin e publikut nga ana e zhvilluesit gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
- ç) Informimin dhe përfshirjen e publikut për organizimin dhe realizimin e dëgjesës publike;
- d) Informimin e publikut dhe marrjen e mendimit të tij nga AKM-ja në fazën e shqyrtimit dhe miratimit të Deklaratës Mjedisore;
- dh) Informimin e publikut gjatë monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit.

2. Informimi i publikut për projektin e propozuar dhe marrja e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së

2.1. Për të bërë të mundur informimin dhe marrjen e mendimit nga publiku dhe OJF-të, AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga zhvilluesi, publikon në faqen e saj të internetit, për 20 (njëzet) ditë rresht, informacionin e plotë të paraqitur nga zhvilluesi. Në publikim AKM-ja sqaron:

- a) procedurën që do të zbatohet për informimin, konsultimin dhe dëgjesën publike për projektin deri në miratimin e Deklaratës Mjedisore;
- b) mënyrën dhe afatin kohor (20 ditë), duke sqaruar që brenda këtij afati mund të jepen mendime për çështjet, që duan të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;
- c) afatin e parashikuar për miratimin e Deklaratës Mjedisore dhe publikimit të saj në faqen e saj të internetit;
- ç) mënyrën dhe afatin e ankimit ndaj procedurës së pjesëmarrjes së publikut dhe Deklaratës Mjedisore.

2.2. Publiku dhe OJF-të japin mendimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.1., të këtij kreu.

2.3. Në rast se projekti i propozuar ka karakter kombëtar, AKM-ja, në komunikimin që bën me zhvilluesin, lidhur me kërkesat për raportin e thelluar të VNM-së, i thekson atij nevojën e informimit dhe përfshirjes së publikut, duke përfshirë të gjitha njësitë administrative vendore që ndikohen nga projekti.

2.4. AKM-ja publikon menjëherë në faqen e saj të internetit komunikimin me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, ku përfshihen edhe mendimet e kërkesat e dhëna nga publiku.

3. Informimi, ndërgjegjësimi dhe konsultimi i publikut nga ana e zhvilluesit gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së

3.1. Me qëllim ndërgjegjësimin e publikut për ndikimet e mundshme të projektit në mjedis, zhvilluesi, gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet në mënyrë të pavarur me publikun për këto ndikime duke kryer:

- a) publikimin e informacionit të plotë për projektin që është paraqitur në AKM, ekspozimin e informacionit që disponon për projektin në një zyrë të posaçme në zonën ku propozohet projekti ose në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse;
- b) anketimin direkt të publikut të qendrave të banuara në zonën e ndikimit të mundshëm të projektit në mjedis;
- c) gjatë publikimit dhe anketimit, sqarimin nga zhvilluesi të qëllimit dhe përcaktimin e mënyrës së kontaktit se ku mund të dërgohen mendimet (adresën postare, numrin e telefonit dhe postën elektronike).

3.2. Mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publikut merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së.

3.3. Zhvilluesi dokumenton materialet e përdorura dhe evidencat përkatëse të procesit të informimit dhe konsultimit me publikun, duke i ruajtur dhe paraqitur ato si pjesë e dokumentacionit të aplikimit për Deklaratën Mjedisore.

4. Procedura e organizimit dhe kryerjes së dëgjësës publike dhe përgjegjësitë e zhvilluesit, AKM-së, ARM-së, NJQV-së për organizimin e dëgjësës

4.1. Zhvilluesi ka këto përgjegjësi:

- a) Njofton AKM-në për dëgjësën publike, duke i dërguar programin për organizimin e saj, raportin e thelluar të VNM-së dhe përmbledhjen joteknike të tij;
- b) Realizon njoftimin e publikut për organizimin e dëgjësës publike;
- c) I dërgon NJQV-së dhe ARM-së nga 30 copë kopje të printuara të raportit të VNM-së dhe të përmbledhjes joteknike të tij, të cilat i vihen në dispozicion publikut të interesuar;
- ç) Siguron mjediset ku do të mbahet dëgjesa me publikun;
- d) Siguron pjesëmarrjen e ekspertit/ekspertëve, që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së, ditën që organizohet dëgjesa publike;
- dh) Merr në konsideratë mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku ditën e dëgjësës dhe i pasqyron ato në raportin e thelluar të VNM-së ose argumenton arsyet e pamundësisë së marrjes në konsideratë.

4.2. AKM-ja ka këto përgjegjësi:

- a) Pas njoftimit nga zhvilluesi, udhëzon ARM-në përkatëse për rolin e saj në realizimin e dëgjësës publike;
- b) Publikon në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjësës publike;
- c) I dërgon zyrtarisht një kopje të njoftimit strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri;
- ç) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;
- d) Merr mendimin e publikut në fazën e shqyrtimit të projektit për Deklaratën Mjedisore;
- dh) Merr në konsideratë rezultatet dhe kërkesat e publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore dhe procesit të VNM-së;
- e) Publikon në faqen e saj të internetit informacionin që disponon për pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të VNM-së për projektin.

4.3. ARM-ja ka këto përgjegjësi:

- a) Bashkëpunon me zhvilluesin dhe NJQV-në për organizimin e dëgjësës publike;
- b) Afishon në ambientet e saj të punës dhe publikon në faqen e saj të internetit njoftimin përkatës për dëgjësën publike;
- c) Ekspozon në ambientet e saj të punës kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;
- ç) Merr pjesë ditën e dëgjësës dhe mban shënim diskutimet e bëra nga të pranishmit;
- d) I dërgon AKM-së raportin për diskutimet e bëra gjatë dëgjësës publike brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dëgjesa publike;
- dh) Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën.

4.4. Njësia e qeverisjes vendore ka këto përgjegjësi:

- a) Publikon në ambientet dhe faqen e saj elektronike njoftimin përkatës për dëgjësën publike;
- b) Ekspozon pranë zyrave të saj kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;
- c) Bashkëpunon me zhvilluesin, duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;
- ç) Nxit përfshirjen e komunitetit në pjesëmarrjen për dëgjësën publike;
- d) Merr pjesë në ditën e zhvillimit të dëgjësës publike.

5. Bashkërendimi paraprak për organizimin e dëgjësës publike

5.1. Zhvilluesi, mbasi ka hartuar raportin e thelluar të VNM-së, njofton AKM-në për organizimin e dëgjësës, duke i dërguar:

- a) planin e punës për organizimin e dëgjësës;
- b) informacionin për konsultimet e kryera gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
- c) kopjen e njoftimit të hartuar sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi;
- ç) kopjen elektronike të përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së.

5.2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, udhëzon ARM-në përkatëse të bashkëpunojë me NJQV-në dhe me zhvilluesin e projektit për realizimin e dëgjësës publike, duke i dërguar informacionin e paraqitur nga zhvilluesi sipas pikës 5.1.

5.3. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e marrjes së njoftimit prej AKM-së, komunikon me NJQV-në në zonën ku propozohet projekti, duke i dërguar një kopje të plotë të informacionit që ka marrë prej AKM-së, si dhe e informon për përgjegjësinë që ka në:

- a) publikimin dhe afishimin e njoftimit për dëgjësën publike;
- b) ekspozimin e përmbledhjes joteknike të raportit të thelluar të VNM-së, pranë zyrave të NJQV-së;
- c) garantimin e pjesëmarrjes së stafit përkatës të NJQV-së në dëgjësën publike;
- ç) nxitjen e komunitetit për pjesëmarrje në dëgjësën publike.

5.4. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, i dërgon strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri një kopje të plotë të tij, e cila e publikon në rrjetet e mundshme të informimit.

5.5. Zhvilluesi, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që i bën AKM-së sipas pikës 5.1, dërgon në NJQV të paktën 100 kopje të shtypura të përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së.

5.6. Nëse zhvilluesi i projektit, mbasi ka njoftuar AKM-në, tërhiqet nga organizimi i seancës dëgjimore, atëherë ai informon menjëherë AKM-në dhe NJQV-në, por jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data që ka njoftuar AKM-në sipas pikës 5.1.

5.7. Nëse AKM-ja njoftohet nga zhvilluesi, sipas pikës 5.6., atëherë ajo informon ARM-në për ndërprerjen e procesit të organizimit të dëgjësës publike.

5.8. Nëse zhvilluesi rifillon procedurën e organizimit të dëgjësës publike, atëherë procesi dhe afatet e parashikuara sipas këtij vendimi fillojnë nga e para.

6. Informimi i publikut për dëgjësën publike

6.1. Zhvilluesi i projektit, paralel me njoftimin e AKM-së, realizon, me shpenzimet e veta, informimin për zhvillimin e seancës dëgjimore. Informimi zgjat 20 (njëzet) ditë rresht dhe përfshin:

- a) publikimin e njoftimit, me informacionin që kërkohet sipas shtojcës I, në median audiovizive e median e shkruar lokale dhe, në rast se projekti ka karakter kombëtar, edhe në median kombëtare;
- b) vendosjen e një table informuese në vendin ku do të zhvillohet projekti, ku njoftimi për dëgjësën publike afishohet për 20 (njëzet) ditë rresht në mënyrë dhe vend të dukshëm;
- c) ekspozimin e materialeve të dëgjësës në zyrat e NJQV-së përkatëse.

6.2. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit që merr nga zhvilluesi sipas pikës 5.1., kryen këto veprime:

- a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;
- b) Afishon në hapësirën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjësën publike.

6.3. ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të AKM-së, sipas pikës 5.2., kryen këto veprime:

- a) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;
- b) Afishon në zyrën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjësën publike;
- c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.

6.4. NJQV-ja, brenda 3 (tri) ditëve nga data e njoftimit të ARM-së, sipas pikës 5.3., kryen këto veprime:

- a) Afishon në mjediset e saj, deri në datën e mbajtjes së seancës dëgjimore, njoftimin për dëgjësën publike;
- b) Publikon në faqen e saj elektronike njoftimin dhe përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;
- c) Ekspozon në zyrën e saj kopje të shtypura të raportit të thelluar të VNM-së dhe të përmbledhjeve joteknike të tij.

6.5. Publiku dhe palët e interesuara mund të japin mendimet e tyre në formë elektronike apo me shkrim deri ditën e organizimit të dëgjësës publike. Mendimet duhet të dërgohen në kontaktet e adresat e përcaktuara nga AKM-ja në njoftimin përkatës.

6.6. Mendimet e dhëna nga publiku, vetëm pranë AKM-së, i dërgohen nga AKM-ja të plota zhvilluesit të projektit, jo më vonë se 4 (katër) ditë nga data e mbajtjes së dëgjësës publike.

7. Zhvillimi i seancës dëgjimore

7.1. Seanca dëgjimore me publikun organizohet në një vend të përshtatshëm, sa më pranë vendndodhjes së projektit dhe jo më herët se dita e 30-të kalendarike nga data e njoftimit të AKM-së prej zhvilluesit, sipas pikës 5.1.

7.2. Ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore janë të pranishëm:

- a) zhvilluesi i projektit me ekspertin/ekspertët që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së;
- b) përfaqësuesi i ARM-së në qark/AKM-së;
- c) përfaqësues të NJQV-së së zonës ku propozohet projekti;
- ç) përfaqësues dhe palë të tjera të interesuara.

7.3. Përfaqësuesit e zhvilluesit prezantojnë rezultatet e raportit të thelluar të VNM-së për projektin, duke mbajtur shënim edhe mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku.

7.4. Publiku dhe palët e tjera të interesuara shprehin mendimet e tyre për rezultatet e raportit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

7.5. Përfaqësuesit e ARM-së mbajnë shënim në mënyrë të pavarur diskutimet e plota të seancës dëgjimore dhe i pasqyrojnë ato në një raport të posaçëm, që i dërgohet AKM-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e mbajtjes së seancës dëgjimore.

7.6. Raporti i dërguar në AKM nga ARM-ja publikohet menjëherë në faqen e internetit të AKM-së.

8. Informimi dhe tërheqja e mendimit të publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore

8.1. AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve mbas marrjes së aplikimit për Deklaratën Mjedisore, publikon në faqen e saj të internetit njoftimin, ku sqaron:

- a) se projekti ka hyrë në fazën e shqyrtimit përfundimtar për lëshimin e Deklaratës Mjedisore;
- b) se publiku dhe palët e interesuara gjatë 20 (njëzet) ditëve mund të shprehin mendime për ndikimet në mjedis të projektit;
- c) postën dhe adresën elektronike të AKM-së, ku mund të dërgohen mendimet;
- ç) se çdo koment, informacion, analizë apo mendim i paraqitur nga publiku vlerësohet i vlefshëm gjatë hartimit të Deklaratës Mjedisore dhe argumenton arsyet kur nuk janë marrë parasysht.

8.2. Deklarata Mjedisore publikohet menjëherë në faqen e internetit të AKM-së, ku publiku dhe palët e interesuara mund të sigurojnë një kopje të plotë të saj.

KREU III

INFORMIMI GJATË MONITORIMIT, ANKIMIMIT DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Pjesëmarrja e publikut në procesin e monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit

1.1. Zhvilluesi monitoron ndikimet në mjedis të projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Deklaratën Mjedisore dhe të dhënat ia dërgon AKM-së, ARM-së dhe NJQV-së;

1.2. AKM-ja, ARM-ja dhe NJQV-ja i publikojnë menjëherë të dhënat e monitorimit të dërguara nga zhvilluesi i projektit në faqen e tyre të internetit;

1.3. Me kërkesë nga palët e interesuara, ARM-ja dhe AKM-ja u sigurojnë kopje të shtypura të të dhënave të monitorimit të paraqitura nga zhvilluesi;

1.4. Publiku mund të dërgojë mendime dhe komente për të dhënat e monitorimit pranë AKM-së dhe ARM-së.

2. Ankimimi dhe dispozita përfundimtare

2.1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin paraprak dhe të thelluar të VNM-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi. Ankimi i drejtohet ministrit.

2.2. Për përmbushjen e afateve kohore të kësaj procedure, institucionet me rol e përgjegjësi në këtë procedurë shkëmbejnë informacionin nëpërmjet komunikimit elektronik, në përputhje me përcaktimet në legjislacionin përkatës në fuqi.

2.3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, kreu IV, i vendimit nr.994, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimarrje", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, agjencitë rajonale të mjedisit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA